



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1** **EURO do të jetë monedha zyrtare e Shqipërisë pas hyrjes në BE!** Priligi për Bankën e Shqipërisë hidhet për Konsultim Publik
- 2** **Plani i Rritjes**
- 3** **SASPAC përmbush detyrat për qershorin, pritët 'thithja' e 215 milionë eurove nga**
- 4** **Pritet vetëm zyrtarizimi, Mërgim Vojvoda le Comon për Udinesen! Përvoja e tretë në Serie A**
- 5** **Botërori 2026/ Franca dhe Anglia do të përballen në finalen e vogël, katër arsyet përse kjo ndeshje vlen**
- 6** **Kuvendi/ PD e PL bojkot! PS përplas me opozitën e re' për spastrimin etnik në ministrën serbe! Balla: S'tallemi me çështjet kombëtare**

Kronikë

Vrasja e Ilir Gjinit në Laç, policia gjen një pistoletë tjetër në vendin e ngjarjes! Dyshohet se vrasësi nuk ka qenë vetëm

Arma e sekuestruar është një revolver, i cili është dërguar për ekspertizë balistike. Hetuesit dyshojnë se në vendin e krimit nuk kanë qenë vetëm autori i dyshuar dhe viktimja, por edhe persona të tjerë që mund të kenë qenë të pranishëm ose të përfshirë në konflikt.



Autori Emiljan Suti dhe policia në vendngjarje

Elvis Hila
11 Korrik, 13:58 | Përditësimi: 11 Korrik, 16:59

Share Post

A A

Një armë e dytë zjarri është gjetur nga policia pranë vendit ku mbrëmjen e 9 korrikut u vra **Ilir Gjini**, në lagjen “Erdogan” te qytetit të Laçit. Arma u zbulua pas një kontrolli të imtësishëm të grupit hetimor, i cili u orientua edhe nga deklaratimet e personave të shoqëruar në polici. Arma e sekuestruar është një revolver, i cili është dërguar për ekspertizë balistike. Ekspertiza pritët të përcaktojë nëse arma është përdorur gjatë ngjarjes, kujt i përket dhe nëse ka pasur shkëmbim zjarri.

Hetuesit dyshojnë se në vendin e krimit nuk kanë qenë vetëm autori i dyshuar dhe viktimja, por edhe persona të tjerë që mund të kenë qenë të pranishëm ose të përfshirë në konflikt. Për vrasjen është shpallur në kërkim Emiljan Suti, ndërsa hetimet vijojnë për zbardhjen e plotë të dinamikës së ngjarjes dhe identifikimin e personave të tjerë të përfshirë.

Suti qëlloi 7 plumba drejt Gjinit, 2 prej të cilëve i prekën organet jetësore. Të dy janë me precedent penal, dhe fqinjë me njëri-tjetrin. Shkak i vrasjes, dyshohet të jetë një konflikt të mundshme mes tyre jashtë vendit ku nuk përjashtohet mundësia të kenë pasur aktivitet kriminal.

LEXO EDHE:
Lezhë/ Kishte kthyer banesën në parcelë për kultivim kanabisi, arrestohet pronari dhe një tjetër! Nën hetim 4 punonjës të OSHEE-së (EMRAT+VIDEO)

I dyshuari, Emiljan Suti ka precedentë të theksuar kriminal, i dënuar me 5 vite burg për kanosje për shkak të detyrës, armëmbajtje pa leje, i arrestuar edhe në Belgjikë për vjedhje. 15 vjet më parë Emiljan Suti arriti t'i shpëtojë edhe një atentati para komisarariatit të Kurbinit. Ai kishte marrë leje për të dalë nga burgu, kur nga një makinë u qëllua me breshëri plumbash, që për fat nuk e kapën.

Ai është vëllai i Gentian Suti, i konsideruar “i forti” i Laçit. Mbi 15 vite më parë, dy vëllezërit janë dënuar me nga 5 dhe 4 vite burg, pasi hapën zjarr pas një përplasje pasi policia i kishte ndaluar për kontroll.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: [Ilir Gjini](#) [Lezhe](#)

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare?

[Të drejtë](#) [Të gabuar](#) [Nuk e di](#)

14 Korrik, 12:01

Lajme të tjera



Lezhë/ Abuzimi me çmimet në plazhe, vijojnë kontrollet nga bashkia! Pushuesit: Kemi paguar 10 euro

Elvis Hila
15 Korrik, 10:08



Lezhë/ Policia kontrole për nivelin e zhurmave në zonën turistike të Shëngjinit

14 Korrik, 15:45



Bregdeti i Shëngjinit 'magnet' për turistët, plazhet mbushen plot! Vizitorët për Report Tv: Jemi të kënaqur! Këtu është shumë pastër dhe bukur (VIDEO)

14 Korrik, 13:11




Sezoni veror/ Kryebashkiaku Pjerin Ndreu: Lezha ka një rritje me 15% të numrit të turistëve, sivjet ka shtim të madh të të huajve! Pastërtia, pika jonë e fortë

14 Korrik, 12:44



Avokati i Popullit inspektim në burgun e Shënkollit: Kushte ç'njerëzore! Mbipopullim i rëndë, duhet të ishte spital, e jo burg me dy psikiatër (VIDEO)

13 Korrik, 16:24



Drejtuksi i mjetit humb kontrollin në aksin Laç-Mamurras, merr para mjetet e parkuara në karburant! Në gjendje të rëndë te Trauma (VIDEO)

13 Korrik, 13:00




Aksion antidrogë në Lezhë, asgjësohen 436 bimë kanabisi! Tre në pranga, mes tyre edhe një grua (EMRAT+VIDEO)

12 Korrik, 10:11




IGJEUM paralajmëron: Sot, situata në qytetin e Laçit është e rrezikshme! 6 qarqet me rrezik më të lartë

11 Korrik, 16:04




Ishte rrëzuar dhe dëmtuar në një zonë malore në Lezhë, Policia dhe Urgjenca i shkojnë në ndihmë të moshuarit! Transportohet te 'Trauma'

11 Korrik, 15:28



Aksident në Mirditë, plagosen 6 kushërinjtë e mitur! 16-vjeçari mori makinën pa leje dhe u përplas me një shtyllë

Elvis Hila
11 Korrik, 10:39



Atentati në Laç/ Ilir Gjini dhe autori ishin grindur në qendër të qytetit, gjendet një pistoletë në vendngjarje! Viktimja kishte humbur bashkëshorten shtatzënë (VIDEO)

10 Korrik, 13:43



Vrasja në Laç/ Ilir Gjini u qëllua me 7 plumba, shkoi për sherr të shtëpia e autorit! Në kërkim Emiljan Suti, i dënuar me 5 vite burg për kanosje ndaj policëve (EMRI)

Elvis Hila
10 Korrik, 07:58

Lajmi i fundit



SASPAC përmbush detyrat për qershorin, pritët 'thithja' e 215 milionë eurove nga Plani i Rritjes

16 Korrik, 16:04





Lajmi i fundit



SASPAC përmbush detyrat për qershorin, pritet ‘thithja’ e 215 milionë eurove nga Plani i Rritjes

16 Korrik, 16:04